



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA SHKODËR

Nr. 1485 Prot
Shkodër, më 24.08.2023



PROTIK INNOVATION CENTER

Nr. 159 Prot
Tiranë, më 24.08.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot më datë 24.08 2023, lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve:

1. **Bashkia Shkodër**, me Kryetar të Bashkisë z. Benet BECI, përfaqësuar në këtë marrëveshje me vendim delegimi nga Zv/Kryetari z. Onid Bejleri, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. I10815124V, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rr. 13 dhjetori, Shkodër, këtej e tutje e quajtur "Bashkia".
2. **Protik Innovation Center**, organizatë jo qeveritare e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 730 date 06.04.2012, me seli në Rr. Papa Gjon Pali II, me Nipt: L22010451T, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv Z. Erion Nako, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. H81128089M, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar; këtej e tutje e quajtur "Protik".

Palët e mësipërme bien dakord për lidhjen e kësaj marrëveshjeje si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të palëve dhe rregullimin e bashkëpunimit në Bashkinë Shkodër, me qëllim zhvillimin e klasave mësimore të akademisë SDA by Protik, programe të kodimit, programim dhe formim në fushën e teknologjive tek të rinjtë në qytetin e Shkodrës, në kuadër të programit të kodimit të mbështetur nga qeveria shqiptare.

Kjo marrëveshje lidhet me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e klasave mësimore të akademisë SDA by Protik, me qëllim rritjen e kapaciteteve në fushën e programimit dhe teknologjive tek të rinjtë në qytetin e Shkodrës.



NENI 2
Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me:

- a) Ligji Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- b) Ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- c) Ligji Nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” i ndryshuar;
- d) Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- e) Ligji Nr. 75/2019 “Për rininë”.

NENI 3
Angazhimet e palëve

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje palët marrin përsipër këto të drejta dhe detyrime:

3.1 Bashkia Shkoder vendos në dispozicion një hapësirë në ambjentet e Shkollës 28-Nëntori, Shkodër sipas planimetrive bashkangjitur, në favor të Qendrës Protik për zhvillimin e klasave mësimore në fushën e programimit dhe teknologjive.

3.2 Qendra Protik detyrohet të përdorë ambientet e qendrës vetëm me qëllim zhvillimin e klasave mësimore të akademisë SDA by Protik, sipas kalendarit i cili do t’i njoftohet Qendrës Protik nga Bashkia Shkoder.

3.3 Qendra Protik angazhohet të mobilojë klasën mësimore me mjetet e nevojshme logjistike me qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për ofrimin e këtij shërbimi. Me përfundimin e marrëveshjes pajisjet, mjetet logjistike mbeten në inventar të Shkollës 28-Nëntori, Shkodër.

NENI 4
Kohëzgjatja e marrëveshjes

3.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të saj dhe do të jetë efektive për 9 (nëntë) muaj.

3.2 Zgjatja dhe Rishikimi i mëtejshëm do të jetë objekti i diskutimit të palëve të Marrëveshjes.

NENI 5
Zbatimi i marrëveshjes

5.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në koordinimin e të gjitha veprimeve dhe nismave që do të garantojnë përmbushjen dhe realizimin me sukses të saj.

NENI 6
Përfundimi i marrëveshjes

6.1 Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a) mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në marrëveshje;

b) shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
c) palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes.

6.2 Secila nga palët duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të marrëdhënieve të Marrëveshjes, duke dhënë sqarime të hollësishme dhe të qëndrueshme mbi këtë ndërprerje.

6.3 Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

NENI 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negocimit dhe me mirëkuptim.

NENI 8

Dispozita të fundit

8.1. Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj duke punuar për realizimin e veprimtarive të përbashkëta.

8.2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dy palët.

NENI 9

Hyrja në fuqi

9.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët.

9.2 Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë.

PËR BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

Z. Benet BECI

Me vendim delegimi

Z/Kryetar

Onid **BEJLERI**



PËR QENDRËN PROTÏK

DREJTUESI EKZEKUTIV

Erion NAKO

SECRETARIA
BASHKIA SHKODER

